




REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT

MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



RAPORT PUNE JANAR-DHJETOR 2020



RAPORT I PUNËS JANARË –DHJETOR 2020 I KRYETARIT TË KOMUNËS Z.BASHKIM RAMOSAJ

Deçan-Dhjetor - 2020

	DEÇANI - DEÇANI - DEÇANI NO
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇANI	DEÇAN MUNICIPALITY
<u>Z. Kryetari</u>	<u>32239</u>
<u>02</u>	<u>22.12.20</u>
DEÇAN DEÇANI	

Raport pune Janar-Dhjetor 2020

Në periudhën raportuese Janar-Dhejtorë 2020 të zyra e kryetarit janë regjistruar 1,114 lënde prej tyre në proces janë 28 janë miratuar 1,073 prej tyre 1 është refuzuar ,1 është pezulluar ,11 janë anuluar .

Sa i përket kërkesave për qasje në dokumenta zyrtare Janar-Dhjetor 2020, nga zyrtari përgjegjës është raportuar se janë parashtrur 22 kërkesa nga organizatat jo qeveritare dhe mediat të cilat kanë marrë edhe përgjigjet e duhura në afat kohorë të paraparë më ligj.

Nënkryetari i Komunës -ka mbajtur takim të vazhdueshmë me qytetarë të komunës së Deçanit ku në bazë të këtyre takimeve ka pranuar edhe kërkesat të cilat i ka adresuar tek organet përgjegjëse, janë diskutuar në këshillin e drejtorëve .Po ashtu ka ndihmuar edhe Kryetarin në punët e përditshme duke qenë afër tij në realizimin e detyrave të shumta.

Zyra për Informim dhe Komunikim –Gjatë kësaj periudhe kohore zyra për Informim në Komunën e Deçanit ka përcjell në vazhdimësi aktivitet ditore , javore dhe mujore ku janë publikuar edhe në portalin zyrtar të komunës <https://kk.rks-gov.net/decan/> në ueb faqen e Komunës,në Youtube dhe në Facebook, ka publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe të gjitha vendimet , rregulloret, projektet , vendimet ,konkurset , njoftimet e zyrës së prokurimit ,njoftimet për anulim njoftimet për dhënie të kontratave, njoftim për shfuqizim të kontratave , dhe shkresa tjera në interes për qytetarët e komunës së Deçanit.Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun ka mbajtur kontakte të rregullta me mediat ku ka përcjellë edhe njoftimet , komunikatat në bazë të aktiviteteve të zhvilluara në komunën e Deçanit, duke i mbajtur mediat e informuara në vazhdimësi për ngjarjet në komunën e Deçanit. Në vazhdimësi ka përcjellë agjendën e kryetarit si në nivel lokal po ashtu edhe në nivel qendrorë , dhe një seri aktivitetesh tjera të cilat i takojnë kësaj zyre anipse në kohë pandemie COVID-19 qytetarët kanë mbetur të informuar për të gjitha ngjarjet dhe aktivitete të komunës sonë.

1. Drejtoria e Administratës Komunale **Janar-Dhjetor 2020**

Drejtoria për Administratë punët dhe përgjegjësitë është e ndërlidhur me shumë sektorë për të funksionuar më mirë:

- Shërbimi për qytetar (zyra pritëse) ,
- Zyra ligjore ,
- Zyrat e gjendjes civile ,Deçan, Strelc dhe Polana
- Zyra për përkthime ,
- Zyra për teknologji informative ,
- Furnizuesi ,
- Shtëpiaku , dhe
- Shërbimi i rojeve të objekteve komunale .

Ne këtë raporte pasqyrohen angazhimet e Drejtorisë për Administratë nga Janari -Dhjetor të vitit 2020 .

Viti 2020 ka qenë vit sfidues për shkak të pandemisë globale KOVID-19 , ku ndikim ka pas edhe në shërbimet administratës komunale .

Ne shumë situata gjatë këtij viti kemi funksionuar me staf të reduktuar bazuar nga rekomandimet e institutit kombëtar të shëndetit publik dhe vendimeve të shtabit lokal të menaxhimit me pandeminë KOVID-19 .

Ne këto rrethana drejtoria për administratë ka hartuar planin për reduktim të stafit dhe mbulimin e nevojave të shërbimeve për qytetarë .

Përkundër këtyre vështirësive , drejtoria për administratë ka kryer shërbime vazhdimisht dhe besoj se ia kemi dalë me suksese përmbushjen e detyrave që dalin nga përgjegjësitë tona .

Nga të gjithë sektorët e administratës vetëm sektori për furnizime ka pasë ngecje për shkak se zyrtari nuk është në gjendje të mirë shëndetësore .

- Zyra për shërbim me qytetarë (zyra pritëse) gjatë kësaj periudhe ka pranuar

31 319 - Lëndë dhe kërkesa të ndryshme . Te gjitha këto lëndë janë proceduar të ekzekutivi komunal , legjislativi dhe të gjitha drejtorive veç e veç .

-Zyra Ligjore ka kryer 181 lëndë të ndryshme si dhe 12 lëndë në proces.

Zyrat e Gjendjes civile kanë lëshuar 29383 (njëzetënëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e tri) certifikata të ndryshme .

-Zyra për teknologji informative ka bërë mirëmbajtjen e të gjitha pajisjeve elektronike si dhe mirëmbajtjen e softuerëve të programeve të ndryshme

-Zyra për furnizime ka pasë ngecje për shkak të arsyeve që i ceka me lartë .

-Shtëpiaku ka bërë mirëmbajtjen e havarive të ndryshme brenda objektit të komunës , mirëmbajtjen e ngrohtores , gjeneratorit si dhe mirëmbajtjen e ambientit në hapësirat gjelbëruese për rrethë objektit të komunës .

Ne formën përgjithësuese këto janë punët e kryera nga Drejtoria për Administratë të

Përgjithshme .

2. Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

Janar- Dhjetor 2020

Janar

- Takimi me përfaqësues të lokaleve afariste në Komunën e Deçanit rreth implementimit të Rregullores Komunale për Caktimin e Orarit të Punës në Subjektet Afariste.
- Diskutim publik me përfaqësuesit e bizneseve në Deçan për Draft Kornizën Zhvillimore të Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028.
- Paraqitja e sugjerimeve për sistematizimin e vende të punës në Drejtori sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës së Deçanit.
- Dorëzimi i sugjerimive, rekomandimeve dhe projekteve që parasheh Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim për zhvillimin ekonomik dhe turistike të komunës, për Draft- Planin Zhvillimor Komunal 2020-2028, të Urbis-Grup.
- Takim në Zyren e Kryetarit me përfaqësues të institutit të kontraktuar, për paraqitjen e planit për procedurat që duhet ndjekur Komuna e Deçanit për zhvillimin e qendres turistike në Bjeshkën e Belegut.
- Takim në Komunën e Deçanit me përfaqësues nga Departamenti për Turizem nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për kapacitet turistike të komunës së Deçanit, projektet dhe planet për zhvillim ekonomik dhe turistik të komunës. Në kete takim kanë marrë pjesë edhe zyrtarë nga drejtorit tjera.
- Takime në Zyre të Kryetarit me banoret e fshatit Dubovik, për projektet infrastrukturore në kete fshatë.
- Takime të rregullta konsultative të Bordit të Drejtorave por edhe të veçanta më Kryetarin e komunës.

Shkurt

- Punëtori dy ditore për Draft- Kornizen Zhvillimore të Planit Zhvillimor Komunal, organizuar nga kompania Urbis - Group dhe komuna, me pjesëmarrjen e të gjitha drejtorive, ku është diskutuar për planet dhe projektet në fushat përkatëse.
- Takim konsultative me komandantin e Policisë në Deçan, zyrtarë tjerë të Policisë në Deçan dhe Drejtorin e Inspekcionit rreth Rregullores Komunal për Caktimin e Orarit të Punës në Subjektet Afariste në Komunën e Deçanit.

- Paraqitja e propozimeve të Drejtoris për Ekonomi dhe Zhvillim për ndryshimet në Rregulloren për Taksat Komunale, e cila ende nuk është ndryshuar dhe pritet që këto ndryshime se shpejti të diskutohen dhe miratohen në Kuvendin Komunal në Deçan.
- Takim në Komunen e Deçanit me Këshillin për Siguri në Bashkësi, ku është diskutuar edhe rreth implemtimit të Rregullores Komunal për Caktimin e Orarit të Punës në Subjektet Afariste në Komunën e Deçanit.
- Se bashku me Zyren e Kryetarit dhe Drejtorin për Urbanizem dhe Planifikim Hapësinorë paraqitja e kërkesë të Kuvendit Komunal në Deçan për ndarjen e hapsirës në Bjeshkën e Belegut për ndërtimin e Qendres Turistike Bjeshkatore në kuader të projektit “Tourism hubs for better tourism offer in less advantaged mountainous areas”. Në bashkëpunim me Komunen e Andrijevices në Malin e Zi, për program Cross Border Cooperation Programme Montenegro – Kosovo 2014-2020 under the Instrument for Pre-accession Assistance (IPA II).
- Takime të rregullta konsultative të Bordit të Drejtorave por edhe të veçanta më Kryetarin e komunës.

Mars

- Kuvendi Komunal në Deçan miraton dhe nxerr vendim për ndarjen e hapsirës për ndërtimin e Qendres Turistike Bjeshkatore në Bjeshken e Belegut.
- Duke u bazuar në gjendjen e krijuar për shkak të Pandemis COVID- 19, dhe shpalljes së gjendjes emergjente shëndëtsore nga qeveria e Republikës së Kosovës, njoftimet për gjendjen e krijuar si në Deçan ashtu dhe në Kosovë janë kryer përmes rrjeteve sociale, përmes ëeb-faqes së komunës, faqes së kryetarit dhe faqes së drejtoris.
- Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe zyra për regjistrimin e bizneseve në kuader të drejtoris, ka punuar me orar të reduktuar për shkak të gjendjes së krijuar me pandemin Covid-19, por ju është përgjigjur nevojave dhe kërkesave të bizneseve.
- Takime të rregullta konsultative të Bordit të Drejtorave por edhe të veçanta më Kryetarin e komunës.

Prill

- Njoftim për bizneset përmes rrjeteve sociale të komunës, për Planin Operacional për Pakon Fiskale Emergjente nga Qeveria e Kosovës, por kemi zhvilluar takime këshilluese dhe ndihmë

për plotësim e dokumentave, pasi që drejtorja ka punuar sipas masave të caktuara nga Shtabi Emergjente i komunës dhe qeveria e Kosovës.

- Njoftim për bizneset lokale në Deçan përmes rrjeteve sociale të komunës, për thirrjen për aplikim për grante “Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar”, 2020 po ashtu takime konsultative në zyre me bizneset për këtë thirrje.

- Takime të rregullta konsultative të Bordit të Drejtorave por edhe të veçanta me Kryetarin e komunës.

Maj

- Debat i dytë publik me bizneset lokale në Deçan, për draft kornizen zhvillimore të Planit Zhvillimore Komunal në fushën e ekonomisë dhe turizmit.

- Njoftime përmes rrjeteve sociale të komunës për bizneset lokale në Deçan, për masat për parandalimin e Pandemis Covid-19, të nxjerra nga komuna dhe qeveria e Republikës së Kosovës.

- Takime në zyrën e Kryetarit të komunës me përfaqësuesit e Kosovo Advocacy & Development Center, për aktivitetet e projektit ndërkufitar “Eco and Outdoor Tourism Actions of Balkan Alps”, (KADC), si shenjëzimi i shtigjeve në zonat malore – Bjeshkët e Nemuna dhe zonat rurale, krijimi i pikave turistike në Deçan dhe regjistrimi i tyre, digjitalizimi i këtyre pikave dhe aktivitete tjera për promovimin e turizmit në komunën tonë. Projektë i financuar nga Bashkimi Evropian përmes programit ndërkufitar IPA. Shtigjet që janë shenjëzuar për ecje nga Bjeshka e Prilepit të Maja e Mariashit, Maja e Vogël, Maja e Qenit, të Bjeshka e Belegut të Maja e Madhe të Qafa e Bogiqes dhe Maja Rupes dhe të Zalli i Rupes, të Bjeshka e Madhe dhe Kurvalla deri të Maja e Gjeravices, të gjitha këto shtigje lidhen me Via Dinarica.

- Iniciuar nga Zyra e Kryetarit të komunës, është kontraktuar konzorciumi Instituti për Ndërmarrësi dhe Biznes të Vogël (IESB) dhe Integra Consulting shpk, për “Vlerësimin ekonomik të ndikimit të pandemisë COVID-19 në ekonominë e Komunës së Deçanit”, me të cilët kemi zhvilluar takim dhe kemi dhënë sugjerimet tona për këtë hulumtim, poashtu ky institutet ka zhvilluar hulumtim edhe me bizneset lokale në Deçan.

- Takime të rregullta konsultative të Bordit të Drejtorave por edhe të veçanta me Kryetarin e komunës.

Qershor

- Në bashkëpunim me televizionin KLAN Kosova, kemi realizuar video për promovimin e resurseve turistike të komunës, në emission Ora 7 – me titull “Rruga që po i jepë jetë Deçanit”.

- Fillimi i regjistrimit të pikave turistike në qytet dhe zonat rurale dhe bjeshkët e Komunës së Deçanit, në kuader të bashkëpunimit me KADC- en, i cili regjistrim ka vazhduar gjatë gjithë vitit dhe do të vazhdoj edhe vitin ardhshme deri sa të plotësohet e gjithë oferta turistike në Deçan.
- Me organizim të Kosovo Mountain Club, grupi prej 44 personave ka vizituar Bjeshken e Prilepit dhe janë ngjitur në Majen e Mariashit, e cila vizitë kishte për qëllim promovimin e resurseve natyrore të komunës së Deçanit.
- Në bashkëpunim me Kosovo Mountain Club me përfaqësues Adriatik Gacaferi i cili i ka propozuar Kryetarit të komunës z.Bashkim Ramosaj dhe drejtoris, që se bashku të paraqesim kërkesen të zyra Zvicerane në Kosovë – Sëiss Contact për krijimin e Via Ferratës – Deçani.
- Takime online se bashku me Kryetarin e komunës më përfaqësues të Sëiss Contactit, Drejtoreshen Argjentina Grozhdani, kemi biseduar për bashkëpunimin mes dy institucioneve, mundësit që se bashku të realizojm aktivitete për zhvillimin e turizmit dhe kemi vendosur që se bashku të bashkëfinancojmë krijimin e Via Ferratës në Deçan.
- Njoftim përmes rrjeteve sociale të komunës për thirrjen për aplikim për grante për binzeset – NMV, nga ana e Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë, dhe takime konsultative me përfaqësues të bizneseve në zyre.
- Paraqitja para Kuvendit Komunal në Deçan e propozimit për bashkëfinancim me Zyren Zvicerane në Kosovë – Sëiss Contact për montimin e Via Ferratës – Deçani, mjete finaciare nga Sëiss Contact 20.150 euro, ndërsa Komuna e Deçanit 20.000 Euro, në bashkëpunim me Kosovo Mountain Club. Propozimi e mori pëlqimin nga të gjithë përfaqësuesit e subjekteve politike në kuvend, dhe u morë vendim që të ndahen 20.000 Euro nga komuna për këtë projektë. Si një projekt me rëndësi për zhvillimin e turizmit në Komunën e Deçanit, falenderojm dhe vlerësojm mbështetjen e Kryetari, Drejtoris për Buxhet dhe Financa dhe të gjithë përfaqësueseve të subjekteve politike (asambleistëve) në Kuvend Komunal në Deçan.
- Që nga muaji Janar e deri muajin Qershor kanë aplikuar për regjistrim të biznesit – 31 biznese, fizikisht në zyre kanë qenë 68 biznese që kanë kërkuar ndihmë rreth bizneseve, 4 kanë qenë online, janë shuar 2. Për heqje apo shtime të aktivitetit kanë qenë 23 biznese, kërkesë për shtim apo ndryshim të njesisë 5 biznese, kërkesë për ndryshim të adresës 4 biznese, kërkesa për ndryshim të drejtorit apo përfaqësuesit të autorizuar 2 biznese, për ndryshim të emrit 2 biznese, për ndryshim të numrit të punëtorëve 1 biznes.

- Takime të rregullta konsultative të Bordit të Drejtorave por edhe të veçanta me Kryetarin e komunës.

Korrik

- Takim me Kryetarin e komunës dhe përfaqësuesit e Outdoor Koosva dhe përfaqësues nga Kosovo Mountain Club, për bashkëpunimin dhe hulumtimin e shpellave në territorin e Komunës së Deçanit.

- Takim me përfaqësues nga KADC dhe Kryetarin për aktivitetet e projektit “Eco and Outdoor Tourism Actions of Balkan Alps”, gjatë 6 muajeve të fund vitit dhe mundësia për bashkëfinancim për tabelen – interaktive të Qendra Informuese Turistike.

- Paraqitja e propozimit para Komitetit për Politik dhe Financa të Kuvendit Komunal në Deçan, për blerjen me bashkëfinancim me KADC, të tabelës informues turistike, në vlerë 7000 euro, 2000 euro participim nga Komuna e Deçanit dhe 5000 euro nga KADC, në kuader të projektit “Eco and Outdoor Tourism Actions of Balkan Alps”. Me pëlqim të të gjitha anëtareve të subjekteve politik në komitet, u miratu kërkesa e drejtoris për ndarjen e këtyre mjeteve. Kjo tabelë informuese turistike do të vendoset këtë fund vitë ose vitin e ardhshëm, në të cilën do të jenë të paraqitura të gjitha kapacitetet turistike natyrore, kulturore dhe çdo resurse tjetër i komunës së Deçanit. Falenderojm dhe vlerësojmë mbështetjen e Kryetarit, KADC-en, Drejtorin për Buxhet dhe Financa, dhe të gjithë përfaqësuesit e subjekteve politike në kuvend.

- Janë shenjëzuar shtigjet për ecje dhe çiklizëm nga Bjeshka e Roshkodolit, Bjeshka e Prilepit – Maja e Mariashit, Bjeshka e Belegut tre kufiri, Zalli i Rupes dhe Pllaqica e Vokshit, Bjeshka e Madhe deri të Maja e Gjeravices ku kalon ViA Dinarica. Këtë vitë janë shenjëzuar shtigjet ecje dhe çiklizëm nga Peja, Deçani zonat malore dhe rurale deri të Juniku në Koshare dhe Qafe Morinës , implementuar nga organizata jo-qeveritare CDF në projektet ndërkufitare Kosovë – Shqipëri, mbështetur edhe nga komuna.

- Takim dhe vizita në teren të pikave turistike dhe vlerave kulturore, me producentin e televizionit të KTV-es Dardan Selimaj, dhe gazetarin Lekë Rezniki, për të bashkëpunuar se bashku dhe realizuar emisione që promovojnë vlerat turistike, kulturore dhe natyrore të komunës së Deçanit.

- Bashkëpunim me Ministrin e Administratës dhe Pushtetit Lokal dhe OSBE-en, në fushën e ndikimit të pandesisë në gjendjen ekonomike në Deçan.

- Takime të rregullta konsultative të Bordit të Drejtorave por edhe të veçanta më Kryetarin e komunës.

Gusht

- Takim – punëtori nga Programi i USAID-it për Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënese (TEAM), implementuar nga DAI Global LLC.
- Xhirimi me Televizionin e KTV-es, për emisionin “Sot”, “Vazhdimi i mullirit mbi 200 vjeçar, në Strellt të Epërm”, të mulliri i “Hajrizaj”.
- Komuna e Deçanit dhe Shoqata Bjeshkëtare Alpiniste “Shkelzen Haradinaj”, në bashkëpunim me Komunen e Andrijevices, janë njoftuar nga Cross Border Cooperation Programme Montenegro – Kosovo 2014-2020, under the Instrument for Pre-accession Assistance (IPA II), se janë përfitues të grantit për projektin “Tourism hubs for better tourism offer in less advantaged mountainous areas”.
- Takime të rregullta konsultative të Bordit të Drejtorave por edhe të veçanta më Kryetarin e komunës.

Shtator

- Nënshkrimi i Marreveshjes së Mirëkuptimit me Sëiss Contact dhe Komunës së Deçanit për bashkëfinancim për shtegun turistik- Via Ferrat Deçani, në Gryken e Deçanit, e cila llogaritet të jetë me gjatë se 300 metra.
- Fillimi i punimeve nga Kosovo Mountain Club dhe OJQ “Marimangat”, nga Peja për montimin e shtegut turistik “Via Ferrata”, Deçani.
- Televizioni KTV-e se bashku me drejtorin, realizojnë videon “Mjaltë nga kosheret e bletëve në Strellc të Ulët”, të z.Hajdin Bajramaj, për programin e mëngjesit “Sot”.
- Televizioni KTV-e se bashku me drejtorin, realizojnë videon të fermeri z.Ali dhe z.Ahmet Zukaj në Beleg.
- Televizion KTV-e se bashku me drejtorin, realizojnë videon “Puna me vek ia ka siguruar të ardhurat familjes së Nife Lataj para dhe pas martesë”, në Carrabreg të Epërm për emisionin “Express”. Të gjitha këto video janë realizuar në bashkëpunim me televizionin KTV-e, për promovimin e resurseve kulturore, natyrore dhe bujqësore të komunës.
- Se bashku me organizaten jo-qeveritare KADC në kuadër të projektit “Eco and Outdoor Tourism Actions of Balkan Alps”, përgjatë dy diteve kemi kryer xhirime në zonat rurale të pikat

turistike mullinjet, kullat, uji i thartë “Gushavci”, prodhuesit e mjaltit, të prodhuesit e prodhimeve natyrale nga qumeshti, të Manastiri i Deçanit, të Pishat e Deçanit, të Gryka e Deçanit dhe Bjeshket e Nemuna në territorin e komunës së Deçanit. Nga të cilat xhirime kemi realizuar tri video për promovimin e resurseve turistike dhe natyrore të komunës, e të cilat se shpejti do të shpërndahen në televizione vendore dhe ndërkombetare dhe rrjete sociale, dhe ëeb faqe për promovim të turizmit.

- Njoftim përmes rrjeteve sociale dhe ëeb-faqes së komunës për bizneset, për thirrjen publike për subvencione të grave ndërmarrëse.

- Punëtori organizuar nga USAID Team dhe menaxhementi i Komunës së Deçanit për rezultatet e gradimit në kuadër të projektit komuna transparente, efektive dhe llogaridhënëse.

- Vizita në terren dhe mbikëqyrje e punimeve të montimi i shtegut të “Via Ferrata – Deçani”, në Gryken e Deçanit.

- Takime të rregullta konsultative të Bordit të Drejtorave por edhe të veçanta më Kryetarin e komunës.

Tetor

- Njoftim në rrjete sociale dhe ëeb-faqe të komunës për bizneset, për thirrjen e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për “Programin e Rimekembjes Ekonomike Masa 8”, dhe takime konsultative në zyre me bizneset për këtë thirrje.

- Njoftim në rrjete sociale dhe ëeb-faqe të komunës për mbështetje ekonomike financiare nga qeveria për bizneset dhe komunat.

- Takim online organizuar nga Asosacioni i Komunave të Kosovës dhe Rrjeti Evropian të Ndërmarrjeve (EEN), synimi i këtij takimi informimi i komunave për rëndesin Rrjetit Evropian të Ndërmarrjeve në sektorin privat të bizneseve, që të zhvillojnë inovacionin dhe të zgjerojnë aktivitetin në teren ndërkombetarë.

- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit mes Komunës së Deçanit, Shoqatës Bjeshkatore Alpiniste “Shkelzen Haradinaj”, dhe Komunes së Andrijevides, për implementimin e projektit “Tourism hubs for better tourism offer in less advantaged mountainous areas”, nga Cross Border Cooperation Programme Montenegro – Kosovo 2014-2020, under the Instrument for Pre-accession Assistance (IPA II), të Bashkimit Evropian.

- Trajnim dy ditorë në Prizren, organizuar nga Asosacioni i Komunave të Kosovës për “Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse dhe vendimmarrja”, pjesëmarrës zyrtarët nga drejtoria.

- Vizita në teren dhe mbikqyrje e punimeve të montimi i shtegut të “Via Ferrata – Deçani”, në Gryken e Deçanit.
- Takime të rregullta konsultative të Bordit të Drejtorave por edhe të veçanta më Kryetarin e komunës.

Nëntor

- Takim online nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me përfaqësuesit e projektit “Promovimi i punësimit në sektorin privat”, për hartimin e Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit në Kosovës.
- Trajnim online dy ditore organizuar nga JTS – CBG – MNE – KOS, me përfituesit e projektit ndërkufitare Mali i Zi dhe Kosovë.
- Njoftim në rrjete sociale dhe ëeb- faqe të komunës për Panairin Nacional të Punës dhe të Karrierës 2020, organizuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe GIZ-i.
- Paraqitja e kërkesës nga Sëiss Contact sipas kërkesës së organizatës “Marimangat”, dhe Kosovo Mountain Club, për mjete shtesë financiare për montimin e Via Ferrata- Deçani, sepse nga 300 metra sa ishte paraparë, për të kryer deri në fund të shkëmbinjeve nevojiten edhe 107 metra shtesë dhe për këtë gjatësi kërkohen mjete të punës në vlerës 7500 euro, si bashkëfinancim 4500 euro do ti ndajë Sëiss Contact dhe 3000 Euro Komuna e Deçanit, dhe në pajtim me Kryetarin e komunës, kemi nënshkruar aneks marrëveshje për bashkëfinancim, që Via Ferrata – Deçani të përfundoj tërësisht në gjatësi 407 metra, por pagesen komuna do ta kryjë në muajin Mars 2021.
- Xhirim i videos nga Televizioni KTV, për emisionin “Sot”, të Mulliri i Fazli Hasanramaj, me titull “ Mulliri dhe oda që u rindërtuan për të ruajtur traditat”. 26.11.2020.
- Vizita në teren dhe monitorimi i punimeve të montimi i shtegut të “Via Ferrata – Deçani”, në Gryken e Deçanit.
- Takime të rregullta konsultative të Bordit të Drejtorave por edhe të veçanta më Kryetarin e komunës.

Dhjetor

- Takim me Drejtorat dhe kompanin “Urbis Grup”, dhe përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë dhe Planifikimit Hapësinor, për konsultime rreth Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028.

- Takim online në Konferencën Vjetore të Ministrisës së Zhvillimit Rajonal, në të cilën u prezantuan aktivitetet dhe planet e MZHR-es, por edhe komunat kishin mundësinë të paraqesin kërkesat, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre.
- Takim në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë me temën “Dialogu mes nivelit qendror dhe lokal për sfidat në sektorin privat”.
- Takim me Kryetarin dhe përfaqësues të organizatës KADC-en, për aktivitetet e përbashkëta, si vendosja e tabelës informuese të Qendra Informuese Turistike, rregullimi i hapësirës të brendshme të kësaj qendre dhe promovimi i tri video për resurset turistike të komunës.
- Përfundimi i shtegut turistik “VIA FERRAT – DEÇANIT”, në gjatësi 407 metra, në Grykën e Deçanit të Kërshi i Qelis. Duke e falenderuar Zyren Zvicerane- SĚISS CONTACT për mbështetje, Kryetarin e komunës, organizatën Kosovo Mountain Club dhe Marimangat për punën dhe bashkëpunimin, Kuvendin Komunal në Deçan dhe drejtorin komunal, ky shteg i ngjijtes do të jetë një ndër pikat apo atraksionet me të veçanta turistike të komunës që do të ndikojnë në zhvillimin e turizmit dhe promovimin e vlerave tona turistike.
- Takim në zyrën e Kryetarit me zyrtaret nga Zyra e Punësimit në Deçan, për sfidat, kërkesat dhe mundësitë ekonomike që mund të ndikojnë të punëkërkuar në këtë zyrë.
- Punëtori online me USAID, me temë: “Prokurimi Publik”, pjesëmarrës drejtorat e drejtorive.
- Seminar online organizuar nga OSBE-ja Misioni në Kosovë, me temë: “Integrimi gjinor në procesin e vendimarrjes”.
- Gjatë vitit 2020, Zyra e Bizneseve në kuadër të drejtorisë ka kryer këto punë, janë pajisur me numer unifikues gjithësej 540 biznese, janë regjistruar 101 biznese të reja, ndryshime në biznes si ndërrim tipi, ndërrim adrese, shtimë të aktivitetit kemi gjithësej 186 biznese, ndërsa këshillim rreth regjistrimit dhe sugjerime kanë kërkuar 218 biznese. Kurse pranë zyrës së bizneseve janë të regjistruara gjithësej 2333 biznese, në Komunën e Deçanit.
- Gjatë këtij viti kemi pasur bashkëpunim me organizata jo-qeveritare ChĚB, kemi vendosur bashkëpunim me organizatën Hiking Njeri, me organizata tjera në fushën e turizmit, ekspertë të ndryshëm në fushat e zhvillimit arkeologjik dhe kulturor të komunës, organizata jo-qeveritare lokale, dhe institucione tjera qendrore.
- Takime të rregullta konsultative të Bordit të Drejtorave por edhe të veçanta me Kryetarin e komunës.

Bujtinat që janë si pika turistike dhe shfrytëzohen nga turistat për fjetje dhe ushqim:

- Në Bjeshkën e Milishevcit dhe Roshkodolit kemi bujtinën e familjes Osdautaj – Kulla që mund të shfrytëzohet edhe për fjetje dhe ushqim dhe bujtina Lojza që shfrytëzohet për fjetje dhe ushqim. Që nga stina e Pranverës deri në Vjeshtë në këto bjeshkë ka mjaft blegtores ku turistët vendore dhe ndërkombëtarë mund të blejnë dhe shijojnë prodhime vendore tradicionale.
- Në Bjeshkën e Prilepit kemi bujtinën e Hulaj, ku mund të shfrytëzohet nga turistët edhe për fjetje dhe ushqim, në këtë bjeshkë gjendet edhe Maja e Mariashit me lartësi afër 2500 metra, dhe është e markuar. Blegtorë për ushqime tradicionale dhe prodhime bio që dalin në këto bjeshkë nga Pranvera deri në Vjeshtë.
- Bjeshka e Belegut një atraksion tjetër për turizëm verorë dhe dimërorë, si pikë e tre kufirit, gjenden dy bujtina që shfrytëzohet edhe për fjetje dhe ushqim, bujtina e Ismet Neziraj dhe bujtina e Skender Vishaj. Në këtë bjeshkë janë shenjësuar shtigjet për ecje dhe çiklizëm, po ashtu gjenden edhe tabela informuese.
- Kulla e Salih Mazrekaj dhe Kulla e Isuf Mazrekaj të Kompleksi i Kullave në Drenoc shfrytëzohen nga anëtarët e turistave edhe për fjetje dhe ushqim.
- Hotel Sëissi në qendër të qytetit të Deçanit, i ofron dhoma edhe për fjetje, qëndrim dhe ushqim për turistat dhe vizitorët tjerë.
- Restaurant dhe Hotel “Kalaja e Deçanit”, i cili ofron dhoma për fjetje, qëndrim dhe ushqim për turistat dhe vizitorët e tjerë.
- Ndërsa kullat në fshatin Isniq, Dubovik, Llukë, Babablloq, Beleg, Strellc, Dranoc, Prilep, etj, janë si pika turistike që mund të vizitohen nga turistat.

Kërkesat dhe disa nga planet e drejtorisë të parapara në Planin Vjetor të drejtorisë drejtuar

Kryetarit:

- Mungesa e subvencioneve në kuader të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim për mbështetje të bizneseve prodhuese, tregtare, gastronomisë, dhe pronarëve të kullave, bujtinave në Komunën e Deçanit.
- Staf i pa mjaftueshëm për fushën e turizmit për promovim dhe shkrim të projekteve ndërkufitare.
- Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Deçanit, e cila do të procedohet pas miratimit të Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028.

- Në bashkëpunim me organizata jo-qeveritare të cilat punojnë në fushën e zhvillimit të turizmit dhe me organizata ndërkombëtare, planifikojmë të krijojmë guiden turistike apo udhërrefyesin turistik të komunës së Deçanit.
- Krijimi i Brendit për prodhimet vendore si ajo e mjaltes, produkteve nga qumeshti, produkteve të mishit, dhe krijimi i brendit për prodhuesit e produkteve nga druri dhe plastika dhe brendit të ujit të Deçanit.
- Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim planifikon në kuadër të bashkëpunimit me organizata jo-qeveritare vendore dhe ndërkombetare, dhe në bazë të planin vjetor të drejtorisë në bashkëpunim me banorët në Zallin e Rupes, në Pllaqicën e Vokshit dhe Bjeshkën e Madhe, të hapë bujtina për ushqim dhe qëndrim për turistë.
- Në bashkëpunim me drejtorit komunale dhe organizata jo-qeveritare vendore dhe ndërkombetare planifikojmë mbajtjen e “Gupa se Gjeravices”, Ditën e Qethave, Panairin Veror, Diten e Gështenjes, Ditën e Veres, Zhdjergat, Darken e Lames, dhe Festivalin Artizanal.

3.Drejtoria Komunale e Arsimit –DKA Janar-Dhjetor -2020

- Takime të rregullta të stafit të Drejtorisë me Drejtorin e DKA-se, ditëve të punës, tema e takimeve: ndarja e detyrave dhe përgjegjësi për stafin e DKA-së.
- Koordinimi me drejtorët e shkollave për detyrat dhe aktivitetet e përditshme zyrtare.
- Përkujdesje dhe monitorim i procesit mësimor në shkollat e komunës së Deçanit.
- 2 Teste (Organizimi i Testeve obliguese nga MASHT: T. i Arritshmërisë (për shkak të pandemisë nuk është mbajtur), Matura Shtetërore - 2020.
- Përkujdesje dhe organizim i Garave të diturisë dhe garave kulturo-sportive në nivel shkollash dhe në nivel komunal.
- Organizimi i trajnimeve të mësimdhënësve konform kërkesave (mundësive) të kohës.
- Përkujdesje dhe angazhim rreth procedurave për ndërtimin e shkollave të reja, renovimin e objekteve shkollore, furnizimin me pajisje dhe mjete mësimore (kabinete, pajisje teknologjike-TIK, pajisje sallave të edukatës fizike).
- Takime pune me Këshillin e Drejtorëve të Shkollave të komunës (tema diskutimi: Organizimi i Procesit mësimor në komunën e Deçanit).
- Takime pune me Koordinatorët e cilësisë në shkollat e komunës (tema diskutimi: Procesit mësimor në shkollat tona, ngritja e cilësisë, zbatimi i KB dhe Garat e ndryshme me nxënës).
- Takim me Këshillin e Prindërve të nivelit komunal.

- Takime pune me: Ministrin e MASHT, Zyrtarët e lartë të MASHT-it, SIA-Pejë, kontakte dhe bashkëpunim me Zyrtarë, Institucione shtetërore dhe OJQ e ndryshme.
- DKA ka kryer Obligimet per mbarvajtjen dhe përgatitjen e Buxhetit për Arsim në nivel komune, duke përfshirë: Administratën e Arsimit, Arsimin Fillor (18 shkolla fillore), Arsimin e Mesëm (2 shkolla), si dhe të gjitha detajet përcjellëse rreth ndarjes, sistemit dhe shpenzimeve të buxhetit në shkolla (në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave).
- Gjatë kësaj kohe janë përcjellë dhe përgatitur statistika, raporte dhe të dhëna nga DKA, për : Shkollat, MASHT, etj., dhe anasjelltas.
- Punë me palë nga zyrtarët e DKA-së (tema të ndryshme, të drejtuara në DKA), etj.

Vërejtje:

Edhe përkundër situatës me Pandemi kemi kryer obligimet e mundshme,por kemi shumë projekte që nuk kemi pasi mundësi t'i zhvillojmë.

Muaji Janar :

- DKA, Takim pune me zyrtarët e DKA-së, tema e takimit: Analizë e shkurtër e punës për vitin 2019, ndarje formale e detyrave për fillim vit sipas Planit të punës të DKA-së për vitin 2020.
- Takim pune, DKA me Ekipen profesionale për hartimin e PZHAK.
- DKA, hartim-Plan pune për organizimin e garave të Diturisë nga niveli shkollor në nivel Komunal, duke u mbështetur në UA nga MASHT.
- DKA, Përgatitja e raportit gjashtë mujor dhe vjetor për vitin 2019. Komunikim me drejtorët e shkollave për plotësimin e statistikave për gjysëmvjetorin e parë, Pranimi i statistikave nga drejtorët e shkollave
- Takim pune në Pejë, projekti për Grantet për Zhvillimin e Shkollave nga Banka Botërore, pjesëmarrës ishin 13 drejtorë nga shkollat tona.
- DKA, Plotësimi i formularit për të gjithë stafin e shkollave, kërkesë nga zyra e personelit
- DKA, Komunikim zyrtar me e-maili, me zyrtarë nga organizata Youth Initiative for Human Rights – Kosovo – YIHR Ks.
- DKA, Takim pune me Komisionin për Hartimin e Draft-rregullores – “Shkolla më e mirë” Çmimi “Nijazi Ferizi”, propozuar nga Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj: Shaban Mehmetaj – koordinator, Mehdi Dodaj, Lumnije Avdiaj, Mujë Avdiaj, Blerim Selmonaj, Burim Hadergjonaj, profi. Ramë Dobraj.
- DKA, komunikim (raport) me drejtorë të shkollave rreth fillimit të gjysëmvjetorit të dytë.
- DKA, Raport në MASHT, ZKA për fillimin e gjysëmvjetorit të dytë (drejtori).
- DKA, Njoftim, drejtorët e shkollave për datën e garave të Fizikës në nivel Komunal, nga organizatori DKA dhe Profesori Ramë Dobraj, rreth organizimit garave të fizikës në nivel Komunal.
- DKA, Shpërndarja e çertifikatave për mësimdhënësit e TIK-ut nga BUSULLA.COM.
- DKA (përfaqësuesi zyrtar) Takim pune në Gjimnazin “V. Frashëri” (KSH).
- DKA, Takim Pune me drejtorët e shkollave. Tema e takimi fillimi i Gjysëmvjetorit Dytë.
- DKA, Takim i organizuar me Prof Dr. Murteza Osdautaj, pjesëmarrës zyrtarë të arsimit, drejtorë shkollash, mësimdhënës dhe dashamirë të librit.
- dt.18.01.2020, mbahën Garat Komunale të Fizikës, nxënësit e shkollave tona (pjesëmarrës mbi 60 nxënës).
- DKA, Hartimi i planit vjetor të punës për vitin 2020.
- dt.23.01. 2020, DKA, Takim pune me Komisionin Organizativ për garat Komunale – për nderë të 17 shkurtit.

- DKA, Hartimi i rregullores dhe orarit të mbajtjes së garave në nivel shkollash dhe komunal.
- DKA, Policia e Kosovës (A. Qeku dhe L. Pepaj) stacioni Deçan, takim me Drejtorin e DKA-së, tema e takimit: Zhvillimi i procesit mësimor në shkollat e komunës sonë.
- Dt.28.01.2020 - DKA, Takim rasti, dalja në pension e Drejtorit Avdyl Shala, SHFMU “ J. Gërvalla” në Prapaqan.
- Dt.30.01.2020, SHFMU “D. e Baballoqit” Baballoq, trajnim me mësimdhënës – përdorimi i TIK.
- MASHT, takim pune, nga DKA: Ramiz Bajramaj, Hysen Balaj, Besarta Tahirukaj dhe Burim Bruqaj, tema: Cilësia në Arsim “shëndeti mental i fëmijëve”.
- Në fillim të muajit Janar, se pari kemi bërë prezantimin e borxheve të vitit 2019 (dhe ato i kemi dërguar në Drejtori të Buxhetit për t’i paraqitur në pasqyrat financiare për arsye se nuk mundemi të kryejmë obligime pa prezentimin e tyre).
- Përgatitja e deponimeve të nënshkrimeve të drejtorëve të shkollave.
- DKA, Ndryshimet në listat e pagave për muajin Janar, nga kërkesat e mësimdhënësve, zëvendësimet-punëtorët e rinj etj.
- dt.10.01.2020, DKA, Konkurs për rekrutimin e stafit (Punëtorëve) të ri arsimor.
- DKA, Vizita në shkollat, Monitorim në: SHFMU “E. Mekuli”, SHMP “Tafil Kasumaj”, SHFMU “Heronjtë e Dukagjinit” - Glllogjan dhe SHFMU “Ardhmëria” – Beleg, Gjumnazin “Vëllezërit Frashëri”.

Muaji Shkurt:

- dt.01.02.2020,DKA, Deçani merr pjesë me nxënësit fitues nga niveli komunal, në Garat e XXI të Fizikës në nivel Republikan.
- dt.01.02.2020,DKA, Deçani merr pjesë me nxënësit fitues nga niveli komunal në Olimpiadën e Matematikës, në nivel Republikan. Lorik Ramosaj (nx. SHMP “T. Kasumaj”) vendi i dytë në nivel vendi, i kualifikuar për Olimpiadë të Matematikës në nivel ndërkombëtar.
- dt.04.02.2020,DKA, konsultim me prof. Shpresa Ramosaj (e autorizuar nga organizatori) rreth testit Kangaroo/ mundësitë e që i ofrojmë ne si DKA për organizimin e garës.
- dt.05.02.2020-DKA, Deçan,Takim pune me zyrtarët e MASHT-it, tema e takimit: Vlerësimi i teksteve shkollore për shkollat pilot, në takim ishin shkollat pilot të komunës se Deçanit: Hamid Qorraj, drejtori i Gjumnazit “V. Frashëri” dhe koordinatori i cilësisë profesori Ramë Dobraj dhe nga SHFMU “Lidhja e Prizrenit”, drejtori Qazim Maloku me zv. Drejtorin Afrim Balaj.
- dt.07.02.2020, DKA,Trajnim njëditor me mësimdhënësit e klasave të IV-ta, dhe të klasave të V-ta (dt.21.02), tema: zbatimi i KKK dhe vlerësimi i nxënësve, Trajner Hysen Balaj dhe Merita Sejda.
- dt.10.02.2020, Kordiantori NRKS, përzgjedhë 3 shkolle dhe bën dhurimin e disa titujve të librave te rinj: Gjumnazi ”V. Frashëri”, SHFMU “Lidhja e Prizrenit”, SHFMU “Bajram Curri”.
- dt.12.02.2020, DKA, Takim me Kryetarin Bashkim Ramosaj, prezentë edhe drejtorët Zenel Kasumaj e Hamid Qorraj, tema e takimit: Pritja e FSK në qendër të Deçanit.
- dt.13.02.2020, DKA, Takim me drejtorin e Gjumnazit “Hasan Nahi” z. Feim Hoxha.
- dt.13.02.2020, DKA, Garat e recitatorëve në nivel komunal (për nderë të 17 shkurtit 2008).
- dt.18.02.2020, DKA, Takim me mësimdhënësit e Edukatës Fizike, organizimi i krosit me nxënës te klasave të IX-ta për nder të “24 marsit – Epopesë së Dukagjinit”.
- dt.20.02.2020,DKA,vizitë pune në Gjakovë – AGIMI-DE.
- dt.02.2020, DKA, komunikim me drejtorët, gjendja gripoze tek nxënësit në shkolle.

- dt.27. 02. 2020, DKA, Dergimin e emrave në MASHT, te arsimtarëve per trajnimin - Udheheqje në Arsim
- dt.28. 02. 2020, DKA-Drejtori i DKA-së, Takim pune me përfaqësues te KFOR-it italian.
- Takim pune-Komisioni punues, përgatitja e draft rregullores për Institucionet Edukativo-Arsimore në komunën e Deçanit.
- dt.10.02.2020, DKA, Konkurs për rekrutimin e stafit (Punëtorëve) të ri arsimor.
- Raporti financiar, me e-mail për 7 shkolla që kanë përfutuar projektin e Huamarrjes,vitin e kaluar.
- Realizimi i pagesave të obligimeve 2019 dhe kërkesave që na paraqiten nga drejtorët e shkollave të cilat kalojnë përmes procedurës së prokurimit pas zotimit.
- Janë kryer te gjitha pagesat e shpenzimeve komunale duke përfshirë: rryma, uji, mbeturina, telefoni etj.
- DKA, Ndryshimet në listat e pagave për muajin shkurt, nga kërkesat e mësimeve, zëvendësimet, punëtorët e rinj etj.
- Vizita pune-Monitorim nga zyrtarët e DKA-së: në SHFMU “Bajram Curri” në Strelle të Epërme,në SHFMU “Sylejman Vokshi”
- Vizitë pune në shkollat: “Jusuf Gërvalla” Prapaqan, “Lan Selimi” p. ndarë Llukë e ulët, “Kuvendi i Verrave të Llukës” Llukë e epërme, në SHMP “Tafil Kasumaj”, në SHFMU “B. Curri” St. i epërme.
- DKA, vizitë në SHFMU “D. e Baballoqit”, trajnimi i mësimeve te kësaj shkolle, tema: Trajnimi i mësimeve/ përdorimi i TIK-ut.
- DKA (zyrtarët), në SHFMU “Drita”, Pjesëmarrje në Kuizin e Diturisë me nxënësit e kësaj shkolle.
- Vizitë, takim me mësime në SHFMU “Dëshmorët e Baballoqit”,më rastin e pensionimit të mësimeve Zenun Selmonaj.
- DKA (zyrtarët), në Gjimnazin “V. Frashëri”, pjesëmarrje në programin festiv për nder të Ditës së Pavarësisë.
- DKA (zyrtarët), vizitë pune në SHFMU “Ardhmëria” në Beleg.
- DKA (zyrtarët),vizitë pune në Gjimnazin “V. Frashëri”, njoftim nga drejtori rreth procesit arsimor.

Muaji Mars:

- dt.02.03. 2020, DKA, Takim pune, krijimi i Komisionit në nivel komunal “Komuniteti i te mësuarit se bashku”.
- DKA, Projekt për Planifikim, Furnizim (pajisje arsimore) me kabinete në shkolla per vitin 2020/21/22
- Drejtorët e shkollave dorëzojnë formularë te inventarizimit te shkollave (kopje fizike).
- dt.03. 03. 2020, DKA,Takim pune me Kryetarin e komunës z. Bashkim Ramosaj, tema e takimit: Organizimi i 7 marsit-Dita e mësuesit, dhe shpërndarja e mirënjohjeve per mësimeve e pensionuar gjatë periudhës 8 mars 2019-7 mars 2020.
- 2 SHFMU: “E. Mekuli” në Maznikë dhe “S. Vokshi” në Prejlep, përgatisin kërkesat për aplikim, investime në efikasitet nga MASHTI - MZHE.
- DKA, Planifikimi rreth trajnimeve te koordinatorëve te cilësisë në nivel shkolle dhe mësimeve tjerë etj.

- Dt.05. 03. 2020 - DKA, Takim pune Ekipa profesionale, njoftim për arsimtarët e shkollës "Rexhep Kadrijaj" rreth procedurave të plotësimit të dokumentacionit për vlerësimin e brendshëm -
- DKA, Takim me zyrtaren e zyrës rajonale të OSBE-se në Pejë , znj Have Lajqi, tema: mundësitë e realizimit të projekteve të ndryshme në shkollat tona, në bashkëpunim me OSBE.
- 06. 03. 2020 - DKA (drejtori), në Prishtinë MASHT, me profesorin Muhamet Haklaj, i përzgjedhur nga DKA, mësimdhënësi i vitit nga Deçani, ceromonia e ndarjes së çmimit - "Shaban Jashari".
- DKA, Shpërndarja e mirënjohjeve për mësimdhënësit e pensionuar - Mars 2019 Mars 2020.
- 09.03.2020 - DKA, Mirënjohjet për prof. Muharrem Kukalaj dhe nx. Lorik Ramosaj, për rezultatin e treguar në garat e Matematikës në nivel republikan.
- Takim pune - Komisioni punues, përgatitja e draft rregullores për Institucionet Edukativo-Arsimore në komunën e Deçanit.
- DKA, Njoftim shkollave, rreth rekomandimeve dhe masave nga IKSHPK kundër COVID-19.
- dt.11.03.2020, drejtori i DKA-së (takim pune) në MASHT, tema e takimit: Situata me Covid 19.
- dt.12.03.2020, DKA, Takim pune me drejtorë të shkollave, tema e takimit: Situata me Covid 19.
- dt.13.03.2020 - Situata në shkollë - Pezullim i mësimin deri me 27 Mars, për shkak të gjendjes së krijuar nga COVID – 19.
- Raport i shkurt për Shtabin Emergjent Komunal, gjendja aktuale në shkollë.

Mars-Qershor 2020

- Drejtoria e Arsimit me të gjitha drejtoritë e shkollave, kanë vepruar menjëherë pas vendimit të qeverisë për ndërmarrjen e masave për parandalimin e COVID-19, kemi formuar ekipet për menaxhimin e situatës.
- dt.04.03.2020, DKA, menjëherë pas njoftimit nga MASHT për përcjelljen e situatës gripoze në shkollë, kemi furnizuar shkollat me mjete hixhenike shpesh dhe kemi rekomanduar për pastrim të vazhdueshëm të hapësirave shkollore.
- Kemi vazhduar me informimin e vetedijesimit të nxënësve për COVID-19 (ora e parë mësimore është mbajtur ligjeratë me nxënësit në klasa).
- DKA, Takim pune me drejtorët e shkollave, është krijuar komisioni në nivel komunal nga shkollat dhe DKA.
- Janë formuar grupet koordinuese në secilën shkollë (me personat përgjegjës dhe drejtorët).
- Janë evidentuar mungesat e nxënësve, raport në DKA nga data 25.02.2020 deri me 11.03.2020.
- Pas ndërprerjes së procesit mësimor, me dt. 12. 03. 2020, Komuna ka organizuar ekipen për dezinfektim të objekteve shkollore, të cilat ekipa kanë kryer punën (dezinfektimin) në të gjitha objektet shkollore.
AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA – Listimi i aktiviteteve të implementuara gjatë periudhës raportuese nga DBPZHR duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Janë ndarë mjete pune për 25-të fermer nga Komuna e Deçanit dhe GLV – Gjeravica. Është bërë themelimi i komisionit të veçantë për ndarjen e mirënjohjeve për fermerët më të mirë për vitin 2019; Janë ndarë mirënjohje për 15-të fermerët më të mirë për vitin 2019-të; Është bërë pastrimi i 20 ha me pishë nga insekti “Tenja Procesionare” në “Sukën e Baballoqit”; Është marrë vendimi për dhënien në shfrytëzim të Eko Tregut; Janë ndarë 300 fidane (gështenjë) për fermerët Deçanas në bashkëpunim me CVNP-në; Janë organizuar mbi 30-të takime dhe seminare të ndryshme me fermerë; Janë mirëmbajtur dhe hapë 20-të kanale për ujitjen e tokave bujqësore; Janë pajisur me NIF mbi 400 fermer për zhvillimin e aktivitetit të tyre bujqësor gjatë pandemisë; Është themeluar komision i veçantë për njoftimin e fermerëve për afatin e aplikimit për subvencione dhe grante; Është përgatitur raport i veçantë për dëmet e shkaktuara gjatë pandemisë në sektorin e bujqësisë; Hapja e afatit për aplikim për subvencione dhe grante (kanë aplikuar gjithsej 723 fermer për pagesa direkte dhe 10 fermer për grante); Hapja e sezonës së korrje shirjeve (janë ndihmuar fermerët me derivate); Është ngritur komision i veçantë për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga breshëri; Janë vizituar 150-të fermerë të Komunës së Deçanit për të parë nga afër dëmet që u janë shkaktuar nga kushtet atmosferike (breshëri dhe shiu) dhe është hartuar raporti për ministrinë e Bujqësisë në vlera financiare për dëmet që u janë shkaktuar fermerëve (180.000E); Është bërë organizimi tradicional i ritit të Qethave në bjeshkën e Pllaqicës së Vokshit; Është organizuar panairit i ushqimeve (produkteve) tradicionale; Është përgatitur raporti për mbjellat e grurit për këtë vit; Janë realizuar mbi 60-të vizita në terren tek fermerët; Janë lëshuar 12 leje për prerjen e pyjeve private; Janë konfiskuar 10.07 m³; Janë shqiptuar 5 gjoba

AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - themelimi i shoqatës së bletarëve dhe blegtorëve në dakordim me Komunën e Deçanit.

1. Shefi i Sherbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP së bashku me referenten e ndryshimeve kadastrale

Gjatë periudhës për të cilën po raportojmë përkatësisht prej fillimit të vitit 2019 e deri me datën e përpilimit të këtij raporti , Zyrtari për RDPP ka pranuar gjithsejtë **250** kërkesa nga palë të ndryshme për realizimin e të drejtave ligjore që dalin nga Regjistrimi i të Drejtave në Pronën e Paluajtshme (RDPP).

Nga të gjitha këto kërkesa deri me tani janë shqyrtuar **245** dhe për të njëjtat janë lëshuar aktvendime adekuate me të cilat palëve iu është njohtë e drejta ligjore e kërkuar ose ju ka refuzuar e njëjta kërkesë dhe ju ka dhënë e drejta e ankesës në organin e shkallës së dytë. Ndërsa **5** kërkesa janë në procedurë e sipër.

Aktvendimet me të cilat palës i është njohtë e drejta në RDPP, në afat ligjor dërgohen te referentja për ndryshime kadastrale e cila konform këtyre vendimeve bënë azhurimin në librat përkatës të elaboratit kadastral dhe të njëjta prapë i azhurno duke i fut të dhënat në kompjuter përkatësisht në programin e SIKTK-es

Krahas këtyre punëve Zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit të shërbimit ka kryer edhe punë tjera nga lëmi i shërbimeve pronësoro juridike dhe së bashku me Referenten për ndryshime kadastrale kanë kryer edhe punë tjera me urdhër të drejtorit .

2. Zyrtarët e mirëmbajtjes së Kadastrit

Në këtë sektor punojnë tre zyrtar për mirëmbajtjen e Kadastrit .Këta zyrtar gjatë periudhës raportuese i kanë pasur **100** azhurime të lëndëve nga terreni sipas kërkesë së palëve siç janë : Ndarja e parcelave, Bashkimi i parcelave, Regjistrimi i Objekteve, korrigjimi i sipërfaqeve, korrigjimi i mexhave dhe futja e të dhënave të reja në sistem etje. Këto lëndë të gjitha janë zgjedhur me përjashtim të **2** rasteve të cilat ende janë në procedurë e sipër.

Gjithashtu këta zyrtar gjatë kësaj periudhe kanë lëshuar **3** historiate sipas kërkesave të palëve dhe kanë lëshuar **356** kopje plani.

Gjatë kësaj periudhe raportuese këta zyrtar kanë dal në teren për **5** raste nga domeni pronësoro juridik e sipas kërkesës zyrtare të bërë nga ana e Komunës së Deçanit, për nevoja të Komunës. Si dhe kanë kryer edhe detyra tjera sipas nevojave të cilat paraqiten në këtë shërbim siç janë konsultat me palë dhe punë tjera në zyre.

3. Referenti për pranimin e palëve

Gjatë periudhës për të cilën raportojmë, referenti për pranimin e palëve ka pranuar gjithsejtë **1844** kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me dhënien e certifikatave të pronës së paluajtshme, kopjeve të planit dhe vërtetimeve me të cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri të paluajtshme, në territorin e Komunës.

I njëjti zyrtar i ka proceduar të gjitha këto kërkesa dhe për secilën kërkesë palët janë pajisur me dokumente përkatëse në afatin brenda ditës së paraqitjes së kërkesës. I njëjti punëtor krahas këtyre punëve ka kryer edhe punët e përpunuesit në SIKTK.

Për hir të thjeshtësimit të të dhënave për punët e kryera të këtyre punëtorëve këtij raporti po ja bashkëngjitem edhe formën tabelore të lëndëve të pranuara sipas muajve dhe llojit të kërkesave .

Lloji i lëndëve	Janar	Shkur t	Mar s	Pril l	Maj	Qersho r	Korri k	Gush t	Shtator	Teto r	Nënto r	Dhjet o	Totali
<i>Ndërri mi i pronarë ve</i>	33	21	19	04	06	12	25	27	23	33	18	02	223
<i>Hipotek at</i>	03	04	05	01	01	04	01	03	02	03	01	00	028
<i>Azhuri mi i lëndëve -Tereni</i>	08	11	09	00	11	20	04	09	15	03	07	03	100
<i>Lëshua rja e certifik atave</i>	125	137	097	001	063	146	436	540	104	101	079	015	1844
<i>Totali për Muaj</i>	169	173	130	006	081	182	466	579	144	140	105	020	2195

Kjo Drejtori krahas këtyre punëve të evidentuara më lartë ka kryer edhe punë tjera të parashtruara konform kërkesave të palëve private dhe organeve komunale.

Bazuar në të dhënat e evidencës së zyrës së pranimit të Komunës së Deçanit, shihet se ne kemi pranuar gjithsejtë 3079 kërkesa prej të cilave del se deri me tani nga këto kërkesa 3069 janë zgjedhur , tri janë refuzuar dhe shtatë janë anuluar.

7.Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte **Janar-Dhjetor 2020**

- Pormovimi I librit “Shpirti Peshon”, nga autorja Fitore Haklaj, më dt.09/01/2020
- Për nder të “Ditës së Pavarësisë”, ekspozitë “Gjenocidi serb ne Kullat Shqiptare”, më dt. 14/02/2020
- 17/02/2020- “Dita e Pavarësisë”
- Turniri në futsallë në futboll për nder të dëshmorëve Zahirrit, Edmondit dhe Hkifit, më dt.01/02/2020
- 30 vjetori I fillimit të aksionit për “Pajtimin e Gjaqeve dhe Ngatërresave” në Lumbardh, më dt.03/02/2020

-Pastaj pavarësisht gjendjes ekzistuese të pandemisë, DKRS ka vazhduar punën dhe përkushtimin në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiave duke respektuar masat e përcaktuara për mbrojtjen e shëndetit nga COVID-19:

- Koncert i mbyllur për nder të “Ditës së Dëshmorëve”, më dt.06/05/2020
- Dita e Qethave, më dt.23/07/2020
- Fillimi i ndërtimit të Qendrës Rinore
- Dita e Gështenjës, më dt.15-17/10/2020
- Përrurimi i Paletres Sportive, më dt.20/10/2020

Arkivi Komunal- Deçan

Arkivi komunal në Deçan funksionin e vetë të punës e kryen në harmoni dhe në përputhje me dispozitat ligjore , në harmoni me rregulloret e pushtetit qendror dhe atë të pushtetit local. Puntorët e këtij sektori kanë bërë sistemimin e lëndëve të arkivit.

Për periudhën Janar-Dhjetor të këtij viti, në arkivin komunal të Deçanit kemi kryer punë dhe detyra të caktuara sipas programit të punës, në mënyrë që sa më e mire të bëhet ruajtja e dokumentacionit arkivor.

Në këtë periudhë kemi pasur një bashkëpunim të ngushtë me Agjensionin Shtetëror të Arkivit të Kosovës , me kryetarin e komunës z.Bashkim Ramosaj dhe Drejtoreshën znj.Leonora Ukëhajdaraj.

Nga poseduesit e lëndëve kemi kërkuar që lëndët të sistemohen, të klasifikohen, të regjistrohen dhe të përpilohet një listë ku shënohen lëndët të cilat duhet të arkivohen në depon në origjinale e jo kopje.

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur pale të cilët kanë kërkuar lëndë të ndryshme për shfrytëzim. Lëndët e kërkuara kanë qenë :raporte të komunave, aktgjykime, aktvendime të ndryshme, lëndët para luftës si dhe dokumentacionet e ish gjimnazit “Sami Frashëri”-Irnziq, gjimnaz ky i mbyllur në vitin 2016, e që dokumentacioni i tij gjendet në Arkivin Komunal.

Dokumentacionet me të cilat janë paisur palët gjatë këtij viti 2020, arrin në 150.

Lëndët e regjistruara në vitin 2020 janë 1.562.

Biblioteka Komunale “Dëshmorët e Lirisë”

Gjatë këtij viti në bibliotekën e qytetit janë regjistruar 376 lexues.

Nga Ministria e Kulturës ,Rinisë dhe Sportit na janë dhuruar 80 tituj, 155 egzemplarë, ndërsa libra të dhuruara nga vetë autorët janë 37 tituj, 49 egzemplarë.

Kurse në bibliotekën dega në Isniq këtë vit numri I lexuesve ka qenë 226.

Nga MKRS-ja, libra të dhuruara kanë qenë 91 tituj , 123 egzemplarë.

Pallati i Kulturës “Jusuf Gërvalla”

Gjatë vitit 2020 në Pallatin e Kulturës „Jusuf Gërvalla” nuk janë zhvilluar shumë aktivitete veprimtarishë kulturore-artistike.

Në bashkëpunim me DKRS janë mbajtur këto aktivitete:

Disa ekspozita me piktorët Deçanas.

Disa takime letrare me shkrimtar dhe poet.

Më 17/02/2020 është mbajtur concert I valleve nga ansambli i Këngëve dhe Valleve , për nder të “Ditës së Pavarësisë”.

Aktivitete të shahut.

Për shkak të pandemisë aktivitetet janë kufizuar në gjysmën e dytë të vitit 2020.

Spektori i Sportit

Janar

- Takime me pedagogët e kulturës fizike të shkollave fillore dhe të mesme.
- Takime me përfaqësues të Federatave të ndryshme të Kosovës.
- Takim me përfaqësuesit e Departamentit të Sportit.

Shkurt

- Takim me kryetartët e klubeve të sportit të komunës.
- Takim me donatorët e klubeve sportive të komunës.
- Aktivitete në diciplina të ndryshme sportive për nder të 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.
- Takim me ekspert sportive ku si temë kryesore do të jetë situatë në sport në komunën e Deçanit.

Mars.....

Prill.....

Maj.....

Qershor.....

Korrik.....

Gusht.....

Shtator

-Takim me pedagogët e kulturës fizike ku do të trajtohen temat për mbarrëvajtjen e garave sportive të vitit shkollor paraparak si dhe do të caktohen datat për organizimin e garave dhe aktiviteteve sportive për sezonin vjeshtor.

Tetor

-Takime në diciplinat e ndryshme sportive të shkollave fillore dhe të mesme .
-Organizimet e garave në atletikë në veqanti maratona e seniorëve ku do të ftohen atlete edhe nga komunat e tjera.

Nentor

-Gara dhe aktivitete sportive të shkollave të mesme të komunës.
-Aktivitete sportive të cilat do të organizohen për nder të 28 nëntorit Ditës së flamurit.

Dhjetor

-Takim me pedagogët e kulturës fizike të komunës sonë ku do të bëhet analiza dhe rekapitulimi I punës së këtij viti për sportin dhe kulturën fizike në përgjithësi.
-Takim me përfaqësuesit e departamentit të sportit dhe mekanizmave tjerë sportive
Do të bëhet shpallja e sportistëve më të mirë për vitin 2020.

8. Drejtoria për Inspeksion **Janar-Dhjetor -2020**

Në Kuadër të Drejtoratit për Inspekcione gjatë vitit 2020, për kryerjen e detyrave të punës sipas lëmive përkatëse kanë qenë të sistemuar; Inspektori i Tregut, Inspektori Sanitarë, Inspektori i Mbrojtjes së Ambientit, Inspektori i Ndërtimit (me Aktvendim si punë sekondare), Inspektori i Veterinës (i angazhuar me kontratë në vepër) dhe Inspektori i Bujqësisë që njëkohësisht është edhe shef i inspektorëve.

Secili nga Inspektorët ka vepruar sipas detyrës zyrtare, sipas kërkesave dhe ankesave të palëve dhe sipas kërkesave të organeve tjera kompetente.

Në mënyrë permanente është bërë mbikëqyrja inspektuese e subjekteve tregtare dhe hoteliere me theks të veçantë lidhur me respektimin e orarit të punës, vendosjen e çmimeve të mallrave për tregtim, afati i skadimit të produkteve ushqimore si dhe kushtet higjienike dhe sanitare të objekteve dhe stabilimenteve.

Është karakteristikë e këtij viti raportues se Drejtorati për Inspekcione përveç punëve dhe detyrave të punëve të bazuar në ligjet, aktet nënligjore përkatëse, rregulloret komunale, dhe Planin e punës për vitin 2020, që nga data 12.3.2020 është ballafaquar me gjendjen e krijuar nga Pandemia COVID-19.

Situata e krijuar nga shfaqja e Pandemisë COVID-19, ka imponuar që shumë aktivitete të planifikuara me Planin e punës së Drejtoratit për vitin 2020, të anashkalohen, dhe prioritet ndër te gjitha prioritetet të përcaktohet Zbatimi i masave të përcaktuara nga Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjithëse, Ligji për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid 19, Ligjit për shëndetësi, manualit për mbrojtje nga përhapja e pandemisë Covid 19, vendimeve dhe udhëzimeve të Qeverisë së RKS-së dhe ministrive përkatëse, si dhe atyre të Shtabit Komunal Emergjent.Fal angazhimit të vazhdueshëm të inspektorëve dhe me një bashkëpunim shumë të

mirë me Shtabin Komunal për menaxhimin e pandemisë, QKMF-në dhe Policin e Kosovës është arritur që pasojat e përhapjes të jenë dukshëm më të vogla.

Në bashkëpunim me IKSHP për personat që kanë rezultuar pozitiv në testin për konstatimin e Covid 19, janë ndërmarr veprimet për karantinimin e të njëjtëve me qëllim të ndalimit të përhapjes së pandemisë.

Krahas atyre të lartcekurave, janë bërë kontrole inspektuese si detyra të zakonshme si; lidhur me ndërtimet pa leje si dhe të atyre në kundërshtim me lejet e lëshuara nga Drejtorati për Urbanizëm, nga Inspektori i Veterinës si kompetencë e deleguar nga Agjencinë e Veterinës dhe Ushqimit është bërë mbikëqyrja e therjes së kafshëve dhe vulosja e mishit të therur neper thertore, është përcjell gjendja e ndotjes dhe degradimit të ambientit, minimumi ekologjik i sasisë së ujit në Lumëbardhin e Deçanit si rezultat i operimit të hidrocentraleve dhe për rastet kur Operatori ekonomik nuk i është përmbajtur elaboratit mbi minimumin ekologjik të sasisë së ujit në shtratin e lumit e për të gjeturat e konstatuara vazhdimisht janë njoftuar inspektorët kompetent të MMPH, është bërë evidentimi i deponive ilegale në tere territorin e Komunës. Është bërë kontrollim i rregullt i subjekteve afariste qoftë e sidomos atyre të tregtisë apo atyre hoteliere, sidomos sa i përket respektimit të masave të përcaktuara anti Covid 19, afatit të skadimit të produkteve ushqimore, mashtrimit të konsumatorëve, respektimit të orarit të punës etj. Në ditën e tregut është bërë mbikëqyrja e tregut të gjelbër edhe pse i njëjti për shkak të masave anti Covid 19 pjesën më të madhe të vitit ka qenë i mbyllur. Janë bërë kontrole sipas kërkesës së Policisë së Kosovës, posaçërisht për mallrat e hasura në transportin rrugor pa dokumente përkatëse përcjellëse por edhe sipas denoncimit të palëve në polici për pa rregullsitë e hasura në subjektet tregtare, ku vlen të theksohet se ka ekzistuar një bashkëpunim mjaft i mirë. Sipas kërkesave të operatorëve ekonomik është bërë pranimi i lokaleve të subjekteve sa i përket kushteve minimale higjienike teknike dhe të mbrojtjes në punë.

Gjatë vitit 2020 inspektorët kanë kryer aktivitetet si ne vijim:

Inspektori	Kontroll inspektuese në teren sipas detyrës zyrtare	Kontroll inspektuese në teren sipas kërkesës së personave fizik dhe juridik	Procesverbale të hartuara për konstatimin e gjendjes	Aktvendime	Kërkesa për gjykatat kompetente
I Tregut	165	58	65	12	7
I Ndërtimit	32	12	12		
Mbrojtjes së Ambientit *					
I veterinës	50	40	27		

Sanitar	268	16	296	12	3
I bujqësisë	110	65	35	12	
GJITHSEJT	625	191	435	36	10

Në tabelën përmbledhëse nuk janë të përfshira të dhënat nga Inspektorja e Ambientit. Deri në kohën për dorëzimin e këtij raporti, Inspektorja e Ambientit, për arsye ende të pa justifikuara, nuk ka dorëzuar raport për punët e kryera.

9. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit Janar-Dhjetor 2020

Gjatë vitit 2020 stafi i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit ka kryer këto shërbime dhe menaxhim të projekteve:

Kryerja e punëve rreth dhënies së kushteve të lokacionit, për ndërtimet e objekteve të reja, adaptimet, rekonstruimet, rindërtimet etj.

Kryerja e punëve rreth dhënies së lejes së ndërtimit (llogaritja e taksave urbanistike dhe atyre mjedisore).

Kryerja e punëve rreth dhënies së lejes së rrënitimit

Pritja e paleve dhe informimi rreth procesit të legalizimit të ndertimeve pa leje

Legalizimi i ndertimeve pa leje

Puna në komisionet për vlerësimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për leje të përdorimit.
Puna dhe pjesëmarrja e hartimit të planit për marrjen e vendimit nga MMPH për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Puna dhe pjesëmarrja e hartimit të planit për marrjen e vendimit nga MMPH për Hartave Zonale.

Puna në komisione vlerësuese për projekte të ndryshme në zyrën e prokurimit

Puna në punimin e paramasave dhe parallogarive për projekte të ndryshme ku investitor është komuna.

Puna në pranimet teknik të projekteve ku investitor është Komuna dhe Ministria.

Puna në futjen dhe përditësimin e të dhënave për numra dhe adresim për komunën.

Përpilimin i mbi 40 kërkesave për: Ministrinë, Ndërmarrje, Korporata, Agjencione të ndryshme për nxjerrjen e buxheteve dhe përkrahjeve ligjore për projekte të ndryshme.

Kryerja e detyrave të ndryshme të dhëna nga drejtori dhe kryetari i komunës.

Hartimi i elaboratit për zona zhvillimore në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nëmura”

Hartimi i detyrës projektuese për hartimin e projekteve për vitin 2020
Hartimi i detyrave projektuese për projektin e rrugës së Bjeshkës së Strellci
Hartimi i detyrës projektuese për rrugën e Gushavcit

Janë lëshuar:

- 11 - Leje të Ndërtimit për Objekte afariste dhe banesore dhe
- 4 - Leje Mjedisore
- 9 - Pëlqime të natyrave të ndryshme
- 2 - Vendime për Leje Rrërimi
- 2 - Vendime për Refuzim
- 4 - Njoftime për natyra të ndryshme
- 3 - Kërkesa për Plotësim Lënde
- 5 - Vendime për emërim të Komisionit për Vlerësim
- 5 - Vendime për emërim të Komisionit për Pranim Teknik
- 1 - Referenca për punë të kryera
- 3 - Pergjigje të kërkesave të ndryshme
- 2 - Njoftime për avokatin publik
- 1 - Vertetim
- 4 - Vendime për dhenie të certifikates së legalizimit
- 1 - Vendim për përfshirjen në liste të pritjes për legalizim
- Janë prezantuar përgjigjet e Lëndëve në Intranet

Mbikëqyrja e punimeve nga stafi i drejtorise për Projektet:

1. Rregullimi i shtratit të Lumit Lumbardh në Deçan -1.3 km
2. Hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Deçanit
(është punuar drafti final për Hartat Zonale dhe Plani Zhvillimor Komunal)
3. Kanalizimi i ujerave të zeza në zonën urbane - 1 km
4. Zgjerimi dhe rikonstruimi i rrugës Prilep-Irznik - 3.5 km
5. Ndërtimi i shetitores - trotuarit në Deçan - 500m
6. Asfaltimi i rrugëve në Deçan, Drenoc, “Arif Demhasaj” në Strellc të Ulet, Ramosaj dhe Demhasaj në Carrabreg të Poshtëm, Dubovik dhe “Agron Hulaj” në Prelep - 18.5 km
7. Përfundimi i projektit në fshatin Sllup,
 - asfaltim 2.5 km,
 - kanalizim 3.2 km,
 - kanale të ujitjes 1 km
8. Ndërtimi dhe riparimi i Memorialeve të Dëshmorëve
 - Busti për Dëshmorin Maxhun Çekaj në fshatin Irznik,
 - Dëshmoret e Kombit në fshatin Carrabregu i Ulët
 - Dëshmoret e Kombit në fshatin Kodrali.
 - Dëshmoret e Kombit në fshatin Isniq,

10. Drejtoria e Shëndetësisë ,Punës dhe Mirëqenies Sociale Janar-Dhjetor 2020

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)'' Adem Ukëhaxhaj'' Deçan

Hyrje:

1. Veprimtaria e QKMF-së përfshin ofrimin e shërbimeve parësore shëndetësore për popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës.
2. Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve të Komunes së Deçanit, t'u ofrojë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse dhe efikase, të bazuar në të dhëna shkencore, përmes caktimit të mjekut familjar i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuesit e shërbimeve në sistemin shëndetësor dhe njëherit pikë referuese për specialistët konsultantë në nivele të tjera të kujdesit shëndetësor.
3. Sipas strategjisë së KPSH dhe standartëve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, ekipi i mjekësisë familjare i përbërë nga një mjekë familjar dhe dy infermiere familjare ofron shërbime shëndetësore për 2000/2500 banorë sipas urdhërimit administrativ 04/2020 me kriter shtrirjen teritoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF-së.

Raporti i punës për vitin 2020

Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës dhe aktëve ligjore dhe nën ligjore, menaxhimi i shëndetit primar shëndetësor është obligim i Kuvendit Komunal gjegjësisht i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.

Organizimi dhe standartet e kujdesit parësor shëndetësor.

☐ Kujdesi parësor shëndetësor organizohet përmes rrejtit të institucionëve shëndetësore në QKMF dhe njësitë përbërëse të saj siq janë:

☐ Qëndrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambulancat e Mjekësisë familjare përmes konceptit të mjekësisë familjare.

☐ QKMF organizon dhe ofron shërbime në kuadër të kujdesit parësor shëndetësor në teritorin e komunës së Deçanit.

☐ Konform numrit të banorëve në komunën tonë numri QMF-ve është 3

☐ QMF ofron shërbime shëndetësore për jo më pak se 10000 banorë dhe duke u zbatu kriteri për një mjekë dhe dy infermiere për 2000 banorë.

☐ Në nivel të QMF ofrohen shërbime të mjekësisë familjare, të shëndetit oral parandalues, konsultativ, diagnostik dhe shërbime të furnizimit me barna.

Rapporti i punës për vitin 2020

Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës dhe aktëve ligjore dhe nën ligjore, menaxhimi i shëndetit primar shëndetësor është obligim i Kuvendit Komunal gjegjësisht i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.

Organizimi dhe standartet e kujdesit parësor shëndetësor.

- Kujdesi parësor shëndetësor organizohet përmes rrejtit të institucionëve shëndetësorë në QKMF dhe njësitë përbërëse të saj siq janë:
- Qëndrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambulancat e Mjekësisë familjare përmes konceptit të mjekësisë familjare.
- QKMF organizon dhe ofron shërbime në kuadër të kujdesit parësor shëndetësor në teritorin e komunës së Deçanit.
- Konform numrit të banorëve në komunën tonë numri QMF-ve është 3
- QMF ofron shërbime shëndetësore për jo më pak se 10000 banorë dhe duke u zbatu kriteri për një mjekë dhe dy infermiere për 2000 banorë.
- Në nivel të QMF ofrohen shërbime të mjekësisë familjare, të shëndetit oral parandalues, konsultativ,diagnostik dhe shërbime të furnizimit me barna.

Implementimin e këtyre shërbimëve e bëjmë në këtë formë:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare e cila qytetarëve u ofrona shërbime 24 orë shtatë ditë në javë me stafë të kompletuar.

1. Qendra e mjekësisë familjare në Strellc e cila funksionon 8 orë në ditë që nga e hëna deri ditën e premte me staf jo të kompletuar siq është e paraparë për implementin e shëndetit primar shëndetësorë.Stafi momental një mjek familjar dhe tri infermiere.
2. Qendra e mjekësisë familjare në Isniq e cila funksionon 8 orë në ditë që nga e hëna deri ditën e premte me staf jot ë kompletuar siq është e paraparë për implementin e shëndetit primar shëndetësorë.Stafi momental një mjek familjar dhe katër infermiere.
3. Qendra e mjekësisë familjare në Irzniq e cila funksionon 8 orë në ditë që nga e hëna deri ditën e premte me staf jo të kompletuar siq është e paraparë për implementin e shëndetit primar shëndetësorë.Stafi momental një mjekë familjar dhe dy infermiere.
4. Ambulata e mjekësisë familjare në Pobergjë orari i punës pesë ditë nga e hëna deri te premten.
5. Ambulata e mjekësisë familjare në Gramaçel për momentin në përfundim të punimëve të objektit të ri.
6. Ambulata e mjekësisë familjare në Lumbardh, e cila funksionon me orar të rregullt me një infermiere.
7. Ambulata e mjekësisë familjare në Prapaqan, e cila funksionon me orar të rregullt me një infermiere.

Stafi : 130 punëtor.

- Drejtori -1
- Mjekë familjarë – 8
- Specialistë Pediatër – 2
- Specialistë gjinekolog – 1
- Specialistë të dermatologjisë – 1
- Mjekë të përgjithshëm 15
- Mjekë stomatolog – 5
- Administratë, stafi i mesëm dhe shërbimet teknike – 87

Meqenëse ky vit për komunën tonë, vendin dhe gjithë globin mund të quhet si vit pandemik me virusin SARS CoV2, andaj që nga fillimi i shpallje së pandemisë nga OBSH, IKSHPK dhe M.SH ne jemi organizuar në harmoni edhe me Shtabin Emergjent Komunal.

Ku mund të konstatojmë se ne si QKMF, QMF-të, AMF-të jemi organizuar në formën më të mirë duke i ofruar qytetarit shërbime në formë patronazhi (vizitë në shtëpi) me ekipe të kompletuara nga stafi mjekësor.

Këtë formë të ofrimit të shërbimeve në shtëpi edhe pse ishte forma më sfiduese dhe shumë e vështirë për tu realizuar ne e zgjodhëm me qëllim të zvogëlimit të përhapjes së infektionit me virusin SARS CoV2, dhe për qytetarë ishte një formë e shkëlqyer me që ju ofroheshin shërbime në shtëpi.

Kjo formë përpos vështirësive tjera kishte edhe një kosto më të madhe duke marrë parasysh se ekipet përbëheshin nga tre persona të personelit mjekësor dhe një autoambulacë.

Ku për gjdo vizitë të bërë janë dashtë të ndrrohen mjetet mbrojtëse (rroba një përdorimshe ,doreza, maskë, kalaqe dhe dezinfektues),

Shërbimet ju janë ofruar çdo pacienti të diagnostifikuar dhe të dyshuar me SARS CoV2 dy herë në ditë të cilët kanë pasur nevojë për terapi paranterale nga ekipet mobile mjekësore. Terapia ishte e ordinuar nga specialistët përkatës.

P.S kjo form e ofrimit të shërbimeve shëndetësore ishte e vetjma si e tillë e organizuar në nivel të Republikës së Kosovës, për të cilën gjë ne morem mirënjohje gojore nga IKSHPK dhe Ministri i shëndetësisë.

Po ashtu morem mirënjohje me shkrim nga inspekcioni shëndetësor i RKS.

Përveq trajtimit të pacientëve të infektuar me SARS CoV2 ne kemi ofruar të gjitha shërbimet tjera të cilat janë të paraparë për kujdesin parësor shëndetësor.

Po ashtu me vendim të M.SH ne si shërbim primar shëndetësor patëm edhe një obligim shtesë ku ishim të obliguar që të krijojmë ekipe mjekësore për parandalimin e infeksionit me CoV2 në Piken Kufitare Kulla me Malin e Zi. Në periudhën kohore Mars – Korrik -2020 me shërbim 24 orë për një javë çdo muaj.

Këtë vit kemi filluar me dy programe të reja :

- a) Shërbimin paliativ dhe me sëmundje malinje në stadin e fundit.
- b) Shërbimin për Nëna dhe fëmijë deri në 36 muaj.

Këtë vit me iniciativën e Kryetarit të Komunës z.Bashkim Ramosaj në bashëpunim me Drejtorin e DSHMS-së dhe Drejtorin e QKMF-së, përshkak të pandemisë me Covid-19 u dakordua që të gjithë mjekët e diplomuar të komunës së Deçanit të punësohen me kontratë për shërbime të veqanta, ku na u krijue mundësia që të kemi ekipe të cilat ishin të domosdoshme për ne.

Qendra Kryesore e Mjekësië Familjare në Deçan funksionon me këto njësi organizative:

1. Departamenti i Mjekësisë Familjare, e cila funksionon me dy turne 7 ditë në javë.
 - a. Reparti i Imunizimit (vakcinimit) ,e cila funksionon 5 ditë në javë.
 - b. Reparti i stomatologjisë, i cili funksionon 5 ditë në javë në dy turne.
 - c. Reparti i Gjinekologjis me akusheri, i cili funksionon 5 ditë në javë.
 - d. Reparti i kujdesit urgjent, i cili funksionon çdo ditë 24 orë
 - e. Reparti i diagnostikës në përbërjen e të cilit janë:
 - Laboratori, i cili funksionon me dy ndërrime
 - Radiologjia,
 - f. Barbatorja, e cila funksionon në dy ndërrime.
 - g. Sistemi Informativ Shëndetësor
2. Departamenti i Administratës:
 - Zyrtar Financiar.
 - Zyrtar për qeshtje Juridike.
 - Zyrtar për mirëmbajtje të arkës.
 - Zyrtar për planifikim dhe zhvillim.
 - Shërbimet teknike ngasësis,pastruesit dhe Depoisti.

Aktivitetet e ZHVP-se ne QKMF -Deçan mbahen qdo vite me qellim te ngritjes profesionale, ofrimin e sherbimeve me cilsore dhe ruajtjes se shendetit te populates ne pergjithesi.

Ligjeratat per mjekë 2020

1. Tema :Diarrhoea , Dr Beqir Beqiraj me dt 09.01.2020.
2. Tema : Semundjet seksuale transmissive - Dr Ahmet Dukaj me dt 24.01.2020.
3. Tema : Kokëdhimbja - Dr Atdhe Agaj me dt 13.02.2020.
4. Tema :Kronologjia e daljes së dhëmbëve Dr Selmon Berisha-Specialist i Protetikës
20.02.2020
5. Tema: Sëmundjet Ishemike të zemres (Infarkti akut i Miokardit) Dr Ismet
Avdimetaj-Specialist i Mjekësisë Familjare 06.10.2020
6. Tema: Konjuktivitete Dr Lulavere Qorraj-Selmanaj-Specialist i Mjekësisë Familjare
20.10.2020

7. Tema:Vaksinimi i obliguar kundër Sëmundjeve Ngjitëse Dr. Skender Ahmetaj – Doktor i Mjekësisë 27.10.2020
8. Tema:Traumat e Kokës Dr Regjep Iberhysaj Doktor i Mjekësisë 03.11.2020
9. Tema:Rubeola Dr Fetije Balaj-Boshtraj –Specialist i Mjekësisë Familjare 10.11.2020
10. Tema: Karcinomi i Gjirit Dr Hilimi Shehaj –Specialist i Gjinekologjisë dhe Obstetrikës 01.12.2020
11. Tema:Diabeti mellitus , Diagnostifikimi dhe Trajtimi Dr Xhavit Rabushaj – Specialist i Mjekësisë Familjare 08.11.2020
12. Tema:I Posalinduri- Neonatusi Dr Hasan Gjikokaj –Specialist i Pediatriisë 15.12.2020

Ligjeratat per Infermijere per vitin 2020.

- | | | | |
|----|--|--------------------|------------|
| 1 | EKG- ligjerate + ushtrime | Dr Hasan Gjikokaj | 26.10.2020 |
| 2 | Pastrimi i plagëve – Dekubitusi | Florijs Ramosaj | 28.10.2020 |
| 3 | Aplikimi i terapisë parenterale i.v...i.m...s.c. | Florijs Ramosaj | 04.11.2020 |
| 4 | RKP-bazik dhe i avancuar | Antoneta Avdimetaj | 11.11.2020 |
| 5 | Aplikimi i masave parandaluse, kunder COVID-19 | Antoneta Avdimetaj | 18.11.2020 |
| 6 | Parametrat Vital | Setki Mushkolaj | 25.11.2020 |
| 7 | Menagjimi i rastit urgjent, Detyrat e infermieres | Antoneta Avdimetaj | 02.12.2020 |
| 8 | Kujdesi per te posalindurin dhe femije te vegjel | Florijs Ramosaj | 09.12.2019 |
| 9 | Kujdesi per pacientin me fraktura , imobilizimi dhe transporti | Antoneta Avdimetaj | 16.12.2020 |
| 10 | Triazhimi i femijeve, detyrat e infermieres | Florijs Ramosaj | 23.12.2020 |

Vështërsit gjatë vitit 2020:

1. Vonesa e përfundimit të objektit të Urgjencës , e cila është tenderuar dhe mbikryrur nga M.Sh e cila e ka penguar mbarëvajtjen e punës në QKMF.
2. Menaxhimi në trajtimin e pacientëve me Covid-19 të konfirmuar (deri në muajin nëntor i kemi trajtuar në shtëpi).
3. Hapsira rreth e përfaqsh objektit e pa rregulluar për shkak të punimeve në rrugë dhe kanalizim.
4. Mos furnizimi i plotë me barna nga lista esenciale, e cila është obligim i M.SH.
5. Shkuarja e 12 mjekëve në specializim .
6. Rrërimi i objektit egzistues në Gramaçel dhe ndërtimi i objektit të ri, i cili për shkak të dimrit nuk është përfunduar.
7. Mungesa e pastrueseve në tri QMF-të dhe pesë AMF-të
8. Mungesa e asensorit për pacientët me nevoja të veqanta dhe nevojat tona.

Të dhënat e prezentuara nga komisioni për Cilësin e Shërbimëve Shëndetësore:

Janë kryer gjithësejt 172 audite , në objektet:

- a) QKMF - Deçan
- b) 3 QMF – Strellc,Isniq,Irznig
- c) 4 AMF – Prapaqan,Lumbardh,Pobergjë dhe Gramaçel.

Nga ky komision ke nxjerrë këto konkluzione kryesore:

- 1) Shumica e ambienteve rrethe objekteve shëndetësore kërkojnë mirëmbajtje.
- 2) Ambientet e pritoreve në mjekësi familjare zgjerimi dhe adaptimi i pritoreve.
- 3) Në observimin klinik duke u bazuar në raportin e të gjeturave nga AQH-ja zvicërene ,kemi përmirësuar mungesat e paisjeve personale profesionale të personelit shëndetësor.
- 4. Niveli i higjienës ka qenë i mirë dhe shumë i mirë.
- 5. Edhe për kundraj se kuti e ankesave janë të vendosura në institucionet tona nuk është gjetur asnjë ankesë ne kutit e ankesave përveq disa ankesave në Drejtori të cilat ishin këshilla dhe urdhërrefyes për punën tonë të përditshme.

Përfundimi: Në bazë të të dhënave të lartëshënuara ju prezantuar punën ,suksesin dhe vështirësitë gjatë vitit 2020

SHTËPIA E REZIDENCIALE E KOMUNITETIT

Raport pune Janar-Dhjetor 2020

Shtëpia e Komunitetit ne Deçan ka nevoja të shumta për të funksionuar ashtu siç duhet, por këtë vit kemi planifikuar duke u bazuare edhe ne buxhetin e këtij viti ti kryejmë këto punë:

Deklarojmë se përpos pagave dhe mëditjeve të stafit tone ne i kemi edhe dy punëtore sigurimi si dhe Neuropsikiatrin si dhe një infermiere po ashtu kemi Psikologen klinike ka qene shume efikase puna e saj dhe ka ndikuar pozitivisht tek pacientet , prania e saj është e domosdoshme, edhe një punëtore teknike të planifikuar për sigurinë dhe mbarëvajtjen e punëve.

Gjatë këtij viti nuk ka munguar përkujdesja për ruajtën e gjësendeve të shtëpisë, orendis shtëpiake dhe gjërave të tjera të shtëpisë.

Shërbimi i personelit të gjithë të punësuarit tërë aktivitetin e punës i kushtojnë shfrytëzuesve e gjithë kjo në harmoni me rendin shtëpiak, orarin e punës janë të obliguar mbajtjen e ditarit të punës, librin e punës dhe pranim dorëzimin e ndërrimit.

Po ashtu gjatë këtij viti kemi patur disa shërbime laboratorike,vaksinimi irezidenteve kemi patur edhe disa vizita, kontrole specialistike pastaj kemi bërë trajtimin e rasteve diagnostikimin dhe mjekimin.

Gjatë këtij viti vlenë të ceket se kemi punuar mjaft me familjarët e tyre dhe në këtë drejtim kemi patur rezultate shumë të mira sidomos me vizitat e familjarëve të cilat po ndikojnë pozitivisht në sjelljet e shfrytëzuesve.

Po ashtu bëjmë evidentimin e familjarëve dhe përshtypjet e tyre për vizitën.

Rëndësi të vaçantë i kushtojmë pastërtisë individuale dhe kolektive, shtëpisë dhe ambientit të jashtëm.

Vlen të ceket që në këtë vit duke u bazuar në buxhetin që posedojmë kemi patur një mbështetje shumë më të mirë dhe më korrekte nga Departamenti përkatës ku kemi qenë mirë të furnizuar me gjërat të nevojshme për shtëpi siç është ushqimin, barnat dhe hixhienën dhe veshmbathjen për të katër stinët e vitit sezonale, këtu tek ne për shkaqe specifike që kanë këta banorë duhet të jemi të gatshëm sepse çdo ditë nevojitet të jemi të gatshëm sepse çdo gjë mund të ndodhë e intervenimet duhet të jenë të menjëhershme kur dihet se janë persona me të meta fizike dhe psiqike dhe dihet dëmtimi i gjerave të shtëpisë.

Realizimi i punëve të planifikuara në këto vite :

Në vend se të realizojmë objektin e mobilimit në është dashur që të realizojmë disa defekte të mëdha të cilat janë dëmtuar dhe nuk janë kryer nga donatori si kanali i ujërave të zeza ishte i dëmtuar dhe është dashur të riparohet i teri po ashtu riparime kemi patur për shkak të defekteve të mëparshëm është dashur të ndërrohen disa pajisje të ujit pijes po ashtu edhe dy banjat janë riparuar për shkak të këtyre defekteve.

Po ashtu shpërndarja e gypave të nxemjes qendrore për shkak të defekteve të kryer nga donatori është dashur të shpërndahen që nga fillimi sepse dimrin e kaluar kemi pasur telashe me shpërndarjen e naftit nga rezervat tek shporetit i nxemjes që për cilën jemi detyruar të pajisemi me një rezervat të brendshëm.

Këtë vit kemi realizuar dhe ndërtuar garazhe për të futur veturat e shtëpisë si dhe një dhomë brenda garazhes për vendosjen e mjeteve rrethimore të shtëpisë.

Po ashtu të dy automjetet që posedon shtëpia janë regjistruar dhe servuar dhe mirëmbajtur brenda një viti

Gjatë Realizimit të objektit të riparuar nga donatori zhvendosja e agregatit ka pasur shumë dëmtime teknike në është dashur që të riparohet për të futur në funksion po i përcjelle me shumë defekte dhe për shkak të kapacitetit të pa mjaftueshëm për të mbuluar të tërë objektin i cili është mbi 300 metra me i madhe.

Po ashtu në kuzhinë jemi pajisur me elemente si shporetit elektrik , mikrovala dhe një shporet ndihmës (tupan)dhe disa gjerave tjera teknike .

Po ne kemi planifikuar dhe realizuar një javë ekskursion për pacientet dhe stafin përcjellës .

Gjatë vitit kemi planifikuar dhe kemi realizuar se në çdo muaj nga një ditë sportive fushore për stafin dhe pacientet si dhe drekë jashtë shtëpisë .Në këtë institucion për shkaqe të specifike që janë (persona me aftësi të kufizuara) gjithmonë duhet të kemi gjera rezerve për t'ju përgjigjur emergjencës .

Këtë vit kemi planifikuar nga Firma Mazreku sh.p.k Malisheve edhe rregullimin e nivelit të oborrit pas shtëpisë sepse e kemi disa nivel me objektin dhe paraqet rrezik si

dhe kemi planifikuar te mbjellim fidanë dhe ta përgatisim për mbjelljen e një kopshti me perime, si dhe vendosjen e pajisjeve te miniparkit ne oborr dhe pajisjen e sallës me pajise sportive dhe fizoreterapeutike.

Vërejtjeje :Projekti i planifikuar dhe ende i paralizuar nga Firma Mazreku sh.p.k Malisheve ende nuk është ralizuar dhe presim brenda këti muaj qe te ralizohët ky projekt.

Këto janë objektivat qe kemi parapare dhe realizuar me suksese, por gjithmonë duke qen falënderues bashkëpunimit me Kuvendin Komunal dhe Drejtorin për Shëndetsi dhe Mirëqenie Sociale.

11. Drejtoria për Buxhet dhe financa Zyra e Tatimit në Pronë Janar-Dhjetor 2020

Për: Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Nga: Anketuesit, Zyra e Tatimit në Pronë

DATE: Nga-01/ 01 / 2020 – 21/ 12/ 2020

Lënda: Regjistrimet e Reja dhe Verifikimet e objekteve në teren

RAPORT TOTAL

VENDI	NR. VERIFIKIMEVE	NR. REGJISTRIMEVE	TOTALI
DUBOVIK	00	2	2
LLOQAN	00	1	1
HULAJ	00	0	0
PRAPAQAN	00	0	0
PAPIQ	00	0	0
POBERGJË	00	0	0
ISNIQ	00	05	05
STRELLC I EPËRM	00	08	08
STRELLC I POSHTEM	00	03	03
DEÇAN	32	114	146
DRANOÇI	00	01	01
GLLOGJANI	00	01	01
LLUK E EPËRME	00	02	02
POZHAR	00	01	01
PRILEP	00	04	04
RASTAVIC	00	04	04
TOTALI:	32	146	178

Arsyeshmëria :Për shkak të pandemisë COVID-19, aktivitete në teren janë anuluar nga Marsi i këtij viti dhe plani i parapar ka mbetur pa u realizuar ne tersi.